



NATURE-BASED SOLUTIONS FOR RESILIENT SOCIETIES  
IN THE WESTERN BALKANS

# ZGJIDHJET E BAZUARA NË NATYRË PËR PËRSHTATJEN NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE PARANDALIMIT TË PËRMBYTJEVE NË BASHKINË

E ELBASANIT





IUCN.ORG/ADAPT  
FACEBOOK.COM/THEADAPTPROJECT

#ADAPT

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit rreziqet meteorologjike janë konsideruar si problematikat kryesore në Shqipëri. Sipas parashikimeve më të fundit<sup>1</sup>, ndërthurja e rritjes së nivelit të thatësirës, që është shkaku kryesor i rritjes së rrezikut të zjarreve në pyje, me shtimin e episodeve të reshjeve ekstreme, do të çojnë në rritjen e sipërfaqeve të gërryera të tokës dhe rasteve të përmbytjeve. Këto fatkeqësi të herëpashershme lidhen drejtpërdrejt me aspektin negativ të ndryshimeve klimatike. Sipas situatës dhe parashikimeve aktuale, Shqipëria renditet ndër vendet me nevojën më të ngutshme për veprim të menjëhershëm në përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

**Bashkia e Elbasanit** renditet e treta për nga popullsia dhe është një nga bashkitë më të mëdha në Shqipëri. Ajo shtrihet në pellgun e lumit Shkumbin, i cili përbëhet nga habitate natyrore të larmishme, që nga liqenet dhe përrenjtë malorë e deri në fushëgropat dhe ligatinat bregdetare. Pellgu i Shkumbinit gjithashtu përbëhet, veçanërisht në rrjedhën e sipërme, nga Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe Rezervati Natyror Kukurman dhe, në rrjedhën e poshtme, nga Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta. Elbasani ndodhet në pjesën e sipërme të pellgut të lumit, një zonë e ekspozuar veçanërisht ndaj rrezikut të përmbytjeve dhe erozionit, për shkak të pyjeve të degraduara në rrjedhën e sipërme dhe shfaqjen e episodeve

të reshjeve të dendura ekstreme. Në këto kushte, rritja e nivelit të ndotjes së ujit paraqet gjithashtu rrezik, sepse duke pasur parasysh faktin që Elbasani ka zona të shumta të prodhimit metalurgjik, ujërat e përmbytjeve mbartin me vete edhe këto rreziqe. Dendësia dhe shfaqja e këtyre episodeve, si edhe ndikimi në mënyrën e jetesës dhe infrastrukturën, pritet të pësojë rritje për shkak të ndryshimeve klimatike. Për rrjedhojë, bashkia ka bërë vazhdimisht thirrje për marrjen e masave të cilat do të bëjnë të mundur restaurimin e kushteve natyrore për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke rritur për rrjedhojë aftësinë ripërtëritëse të komunitetit.

<sup>1</sup> IPCC, 2021: Climate Change 2021: The Physical Science Basis. Contribution of Working Group I to the Sixth Assessment Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change [Masson-Delmotte, V., P. Zhai, A. Pirani, S.L. Connors, C. Péan, S. Berger, N. Caud, Y. Chen, L. Goldfarb, M.I. Gomis, M. Huang, K. Leitzell, E. Lonnoy, J.B.R. Matthews, T.K. Maycock, T. Waterfield, O. Yelekçi, R. Yu, and B. Zhou (eds.)], Cambridge University Press. In Press.





**Figura 1.** Peizazhi pyjor i degraduar i cili nuk ushtron funksionet e tij natyrore (Pellgu i Currës, Shushicë, Elbasan)

Rreziku nga përmytjet dhe erozioni shkakton rrjedhje të tepruar në sipërfaqe për shkak të tokës dhe pyjeve të degraduara, zakonisht të ndërthurura me episode shirash të rrëmbyeshëm. Nëse mbulesa bimore nuk zhvillohet mjaftueshëm dhe nuk arrin të përthithë reshjet e dendura, sasia e tepërt e ujit do të përfundojë në përrrenj dhe lumenj për një periudhë të shkurtër kohore, duke shkaktuar përmytje të befta nga përrrenjtë në zonat e rrjedhës së sipërme dhe po ashtu përmytje masive në pjesët e rrjedhës së poshtme të lumenjve të mëdhenj. Degradimi i tokës përbën një qark vicioz, sepse sa më shumë të degradohet ajo aq më pak pjellore do të jetë, dhe për rrjedhojë rigjenerimi i pyjeve do të jetë i pamundur pa

ndërhyrjen e njeriut, veçanërisht në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Bashkia e Elbasanit përballet me sfida të ndryshme mjedisore që kanë ndikime të ndjeshme në mënyrën e jetesës, infrastrukturë dhe biodiversitetit. Një prej shkaqeve kryesore është degradimi i peizazheve pyjore, i cili sjell ndikime të dukshme, të tilla si tokat djerrë dhe aspak pjellore, rrëshqitjet e dheut dhe përmytjet si edhe humbjen e biodiversitetit. Peizazhet e degraduara nuk mund të sigurojnë shërbimet e tyre natyrore të ekosistemit, duke përfshirë sigurimin e oksigjenit dhe neutralizimin e karbonit, ruajtjen e habitateve të biodiversitetit, prodhimin e burimeve natyrore për të ardhurat e komuniteteve vendore, etj.

## Çfarë janë Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN)

**Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN)** janë përkufizuar nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), si veprimtari që synojnë mbrojtjen, menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e ekosistemeve natyrore apo të modifikuara, të cilat zgjidhin sfidat shoqërore (p.sh. ndryshimet klimatike, sigurinë ushqimore dhe ujore ose fatkeqësitë natyrore) në një mënyrë të efektshme dhe të përshtatur, dhe njëkohësisht sigurojnë mirëqenien e njeriut dhe përfitimet e biodiversitetit.

Zbatimi i ZBN-ve çon në krijimin e ekosistemeve të shëndetshme dhe funksionale për ruajtjen e natyrës dhe për rrjedhojë për sigurimin e përfitimeve për shoqërinë. Ndërhyrjet ZBN në peizazhet e degraduara pyjore mund të sigurojnë restaurimin e shërbimeve të ekosistemit, duke rritur për rrjedhojë aftësinë ripërtëritëse si të ekosistemit ashtu edhe të komuniteteve vendore ndaj ndryshimeve klimatike dhe duke përmirësuar përfundimisht mënyrën e jetesës.

## Si e vlerësojmë problemin dhe zgjedhim zonën për ndërhyrjen ZBN?

Me iniciativën ADAPT\*, Zyra Rajonale e IUCN-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ECARO) ka punuar në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU) dhe Bashkinë e Elbasanit, për të vlerësuar situatën dhe për të gjetur zgjidhjet më të mira ndaj problemit në zonën e zgjedhur. Një ekip ekspertësh ndërkombëtarë

dhe kombëtarë kryen një vlerësim të gjendjes fillestare, në mënyrë që të identifikonin zonat prioritare dhe të adresonin sfidat kyçe, të cilat mund të adresoheshin përmes zbatimit të Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë. Ky vlerësim përqendrohej në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për gjendjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve, kontekstit socio-





**Figura 2.** Proces i zakonshëm i përrënje dhe përmytjeve të fshatit Shushicë në pellgun e Gurrës

ekonomik, përfshirjes gjinore dhe politikës aktuale mjedisore. Aktorë të ndryshëm të nivelit vendor dhe qendror luajtën një rol vendimtar dhe u konsultuan në çdo hap të këtij procesi. Aktorët identifikuan zbutjen e përmytjeve dhe erozionit, zvogëlimin e ndotjes së ujit dhe pasurimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit si objektivat kyçe mjedisore për t'u adresuar.

Informacioni i mbledhur gjatë këtyre konsultimeve, i ndërthurur me një analizë shumë-disiplinore, u dha mundësinë ekipit të ekspertëve të rekomandonin si zonë prioritare pellgun e Gurrës, të ndodhur në fshatin e Shushicës. Komuniteti vendor në këtë zonë ndikohet ndjeshëm nga rreziku i erozionit dhe përmytjet. Për rrjedhojë, janë sugjeruar dy llojet e ndërhyrjeve ZBN:

- **Restaurimi i peizazhit pyjor dhe;**
- **Rregullimi i rrjedhës dhe prurjeve pa kriter të aluvioneve me prita kontrolluese.**

## Cilat janë masat e ndërhyrjeve ZBN të propozuara për zonën e përzgjedhur?

Dy prej masave të propozuara të Zgjidhjeve të Bazuar në Natyrë përqendrohen në Restaurimin e Peizazhit Pyjor (RPP) për të zvogëluar rrezikun e erozionit dhe rritjen e kapacitetit mbajtës të ujit në shpate. Këto masa do të ndërthuren me prita të depërtueshme kontrolluese për të ngadalësuar rrjedhën e përroit të Gurrës gjatë episodeve me reshje ekstreme dhe **për të zvogëluar rrezikun e prurjes së aluvioneve.**

### Masat e buta RPP

(prita konturuese dhe mbjellje pemësh)

Përshtrohen për shpate mesatare që përballen me degradimin e tokës dhe të pyllit. Ato mbështeten në ndërtimin e pritave konturuese me kënde të drejta në shpate dhe mbjelljen e pemëve dhe shkurreve për të krijuar një thyerje të relievit të shpatit dhe për të rritur përthithjen e ujit në tokë. Ato janë një mënyrë e shpejtë për rigjenerimin e peizazhit

pyjor dhe shërbimeve të lidhura me të, duke zvogëluar kështu erozionin, parandaluar rrëshqitjet e dheut dhe siguruar ndikim pozitiv ndaj përmytjeve në zonat e rrjedhës së poshtme. Produktet e pemëve dhe bimëve të mbjella (p.sh. drurë, fruta, prodhime mjekësore, etj.) sigurojnë gjithashtu mundësinë për përfitime ekonomike të komunitetit në zonë. Kjo masë ka për qëllim restaurimin e 2.3 ha të peizazhit të degraduar, përmes një ndërthurjeje të ndërhyrjeve të buta mekanike dhe mbjelljes së dy llojeve të kombinuara në shtresa të ndryshme, ku të dyja llojet mund të sigurojnë përfitime të mundshme ekonomike për komunitetin e zonës.

Veprimet:

- Krijimi i 15 pritave prej dheu (40 cm-të larta) me sipërfaqe 5 metra, të stabilizuara me anë të bimëve të mbjella foragjere apo gurëve.
- Mbjellja e pothuajse 700 fidanëve të dëllinjës së zakonshme, të cilat mund të përdoren për prodhimin



e produkteve kozmetike, barnave, pijeve alkoolike dhe aromatike, të tilla si "Raki". Në përfundim, gjethet mund të përdoren gjithashtu si lëndë djegëse për ngrohjen e furrave.

- Mbjellja e pothuajse 2,600 fidanëve rrushkull, rrënjët e të cilave përdoren për qëllime mjekësore

## Masat e forta RPP

(barrierat dhe mbjellja e bimësisë)

Rekomandohen për shpatë të pjerrëta dhe peizazhe të degraduara në mënyrë të theksuar ku janë formuar hone të thella e të mëdha, që parandalojnë rritjen natyrore të bimësisë. Ndërhyrja, për rrjedhje, përqendrohet në trajtimin e këtyre honeve duke i bllokuar ato me një mori barrierash pothuajse natyrore. Këto barrierat, të bëra prej druri ose gurësh, do të ngadalësojnë gradualisht rrjedhën dhe do të lejojnë ripërtëritjen e tokës. Po ashtu, edhe në hone do të mbillet bimësia e përshtatshme, si pemë, drithëra të përvitshme ose bimë foragjere të cilat do të sigurojnë burime shtesë natyrore për komunitetin e zonës, por gjithashtu do të shmangin zgjerimin e mëtejshëm të honeve dhe humbjen e sipërfaqes së tokës. Masa e dytë ka në plan dy zona prej 1.1 ha dhe 1.6 ha me terren mjaft të degraduar dhe të pjerrët. Honet

e mëdha do të trajtohen me gurë të depërtueshëm ose barriera prej druri dhe do të mbillen me bimësinë e përshtatshme, të tilla si pemë, drithëra të përvitshme ose bimë foragjere. Përveç përfitimeve të drejtpërdrejta ekonomike nga prodhimi i llojeve të pemëve të mbjella, do të zbutet edhe kërcënimi për zgjerimin e mëtejshëm të honeve dhe humbjen e tokës së punueshme.

Veprimet:


- Ndërtimi i 60 barrierave është parashikuar për të trajtuar honet, me një shpërndarje të rregullt përgjatë shpatit, nga 10 deri 15m, për të ngadalësuar gradualisht rrjedhën dhe për të lejuar rritjen e sipërfaqes së tokës.
- Mbjellja e afërsisht 420 drurë lisi, të posaçëm për restaurimin afatgjatë të tokës, por gjithashtu për nxjerrjen e përfitimeve nga prodhimi i gjethëve, lëvoreve dhe fryteve.
- Mbjellja e afërsisht 340 drurë frashri, të cilat kanë dobi mjekësore me spektër të gjerë.
- Mbjellja e afërsisht 3000 rrënjëve trëndafila të egër, të dobishëm posaçërisht në prodhimin e fryteve të tyre.

## Prita të depërtueshme kontrolluese (rregullimi i rrjedhës dhe transportimit të ngarkesës së shtratit lumor)

Masat gjithashtu kanë për qëllim të ndërtojnë një sërë barrierash të depërtueshme të bëra prej gurësh, por brenda shtratit të përroit të Gurrës, në vendndodhje strategjike të zonës së rrjedhës së sipërme. Këto prita të mëdha kontrolluese nuk kanë për qëllim të krijojnë rezerva ujore, por të ulin shpejtësinë e ujit

në rast episodesh përmbytjeje, duke zvogëluar për rrjedhje prurjet e aluvioneve në zonat e rrjedhës së poshtme dhe po ashtu duke zvogëluar erozionin e brigjeve gjatë episodeve të përmbytjeve. Kjo masë përqendrohet në ngadalësimin gradual të rrjedhës së përroit në pellgun e Gurrës gjatë episodeve me shira të rrëmbyeshëm dhe prurjeve të aluvioneve. Këto prita për rrjedhje do të bëjnë të mundur prurjet e afërsisht 7,128 tonë aluvioneve në vit.

Figura 3. Zonat e zgjedhura për zbatimin e masave të propozuara ZBN, fshati Shushicë në pellgun e Gurrës






Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) po bëhen gjithnjë e më të njohura në nivelin ndërkombëtar për të luftuar ndryshimet klimatike, dhe IUCN është në krye të kësaj nisme. Shqipëria ka mundësi për të siguruar ndërhyrje ZBN për shkak të ekosistemeve të saj të pasura, por në të njëjtën kohë ka nevojë të ngutshme për këto ndërhyrje për shkak të ekspozimit ndaj ndryshimeve klimatike. Ndërhyrja ZBN në Bashkinë e Elbasanit është pjesë e \*ADAPT: Nature-based Solutions for resilient societies (ADAPT: Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë për shoqëritë me aftësi ripërtëritëse), e cila është një iniciativë tre vjeçare e financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin në Zhvillimin Ndërkombëtar (Sida) dhe e zbatuar nga IUCN. Puna e ADAPT përqendrohet në rritjen e aftësisë ripërtëritëse të ekosistemit dhe të komunitetit ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve nga fatkeqësitë duke zbatuar Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë. Projekti ka në fokus bashkëpunimin me partnerë të nivelit vendor dhe rajonal për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin ndaj ZBN-ve për klimën dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe i ndërthur veprimet me planifikimin e duhur klimatik dhe me politikat dhe strategjitë për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.



A D A P T  
NATURE-BASED SOLUTIONS FOR RESILIENT SOCIETIES  
IN THE WESTERN BALKANS





ZBN-të brenda kornizës së iniciativës ADAPT do të zbatohen përmes dy projekteve pilote. Qyteti i Elbasanit, lokaliteti i fshatit Shushicë dhe përroi i Gurrës u zgjedhën posaçërisht si zonat për ndërhyrjen ZBN në Shqipëri. Përmes projektit pilot, masat për restaurimin e ekosistemit do të zbatohen me qëllim zvogëlimin e fatkeqësive dhe rritjen e aftësisë ripërtëritëse kundrejt ndryshimeve klimatike. Përfshirja e grave të komuniteteve të zonave është thelbësore për krijimin e mundësisë së përfshirjes së aspektit gjinor në ndërhyrjet ZBN, veçanërisht për të siguruar një qarkullim të vazhdueshëm të të ardhurave për gratë e fshatrave. Projekti pilot ZBN, për rrjedhojë, do të përfshijë në mënyrë aktive gratë e komunitetit në faza të ndryshme të zbatimit dhe mirëmbajtjes së projektit, që nga ndërtimi i pritave e deri tek mbjellja dhe mbledhja e produkteve frutore.



[ecaro@iucn.org](mailto:ecaro@iucn.org)

[www.iucn.org/ecaro](http://www.iucn.org/ecaro)

[www.facebook.com/iucn.ecaro](https://www.facebook.com/iucn.ecaro)

[twitter.com/IUCN\\_ECARO](https://twitter.com/IUCN_ECARO)

[iucn.org/adapt](http://iucn.org/adapt)

[facebook.com/theadaptproject](https://facebook.com/theadaptproject)

#ADAPT